

Në bazë të nenit 8, e në lidhje me nenin 38 të Ligjit të përmendoreve (“Fl. zyr. MZ”, nr. 40/08, 40/11 dhe 02/17) dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës”, nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, më 25. 03. 2019, në bazë të pajtueshmërisë paraprake të Ministrisë së kulturës, nr. UP I 01-28/4 të datës 07. 03. 2019, nxjerrë:

**Programin për ndryshimet dhe plotësimet e
Programit të ngritjes së përmendores kushtuar heroit të madhë legjendar dhe
prijësit Gjergj Kastrioti - Skenderbeu**

Me këto ndryshime dhe plotësime të Programit, bëhen ndryshime dhe plotësime të Programit të ngritjes së përmendores të cilën me nismën e shoqatës OJQ “Don Gjon Buzuku” nga Ulqini, Kryetari i Komunës së Ulqinit, më 19. 07. 2018, me numër 01-965/18 ia ka dorëzuar Ministrisë së kulturës me qëllim të dhënies së pëlqimit.

Ministria e kulturës me Aktvendimin nr. 01-95/3 të datës 23. 07. 2018 e ka dhënë pëlqimin paraprak.

Neni 1

- Në emrin Programi i ngritjes së përmendores kushtuar heroit të madh legjendar dhe prijësit Gjergj Kastrioti, pas fjalës “Kastrioti” shtohet fjala “Skenderbeg”.
- Në nenin 1, paragrafi 1, pika 1 të Programit fshihet fjala “Gjurad”, e pas fjalës “Kastriot”, shtohet fjala “Skenderbeg”, në pikën 6 pas fjalës “Kastrioti” shtohet fjala “Skenderbeg” dhe në pikën 7 fshihet fjala “Gjurad”, e pas fjalës “Kastriot”, shtohet fjala “Skenderbeg”.
- Në paragrafin 2, pika 2, pas fjalës “Kastriot”, shtohet fjala “Skenderbeg”.
- Në paragrafin 4 fjalët “dhjetor 2018”, zëvendësohen me fjalët “tetor 2019”.

Neni 2

Ky Program hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numër: 02-60/19-12a
Ulqin, më 25. 03. 2019

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
KRYETARI,
Dr. Ilir Çapuni, d.v.